



Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR MIRATIMIN E DISA ELEMENTËVE PËRMBAJTËSORË TË FLETËS SË
VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2 të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ – së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë tjetër që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Neni 98, pika 1 parashikon kompetencën e KQZ-së për përgatitjen e fletëve të votimit.

Neni 97 pika 1 parashikon se për zgjedhjet për Kuvend, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore.

Neni 25/1 pika 2 parashikon që fleta e votimit për zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit është e njëjtë, por me një element të veçantë dallues me fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, Drejtoria e Ligjshmërisë ka hartuar projektvendimin “Për miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 97, pika 1 parashikon se për zgjedhjet për Kuvend, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore.

Referuar nenit 98 të Kodit Zgjedhor, fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së. Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë.

Përveç elementeve të sigurisë së letrës, fleta e votimit do të përmbajë dhe disa elementë teknikë në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit si dhe elementë të tjerë identifikues që nuk lexohen me sy të lirë (QR code). Të gjithë këto elementë janë përcaktuar në vendimin nr. 6, datë 6.2.2025 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025” dhe në vendimin nr. 7, datë 14.2.2025 “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

Qëllimi i këtij projekt vendimi është të përcaktojë elementët përmbajtësorë që do të këtë fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, pra ato elementë që pavarësisht përmbajtjes së fletës së votimit që do të miratohet rast pas rasti, do të jenë të njëjtë në çdo tip të fletës së votimit pavarësisht zonës zgjedhore përkatëse. Elementët përmbajtësorë janë listuar në lidhjen 1 që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe përbëhen nga: a) elementë të përgjithshëm, b) elementë në formën e tekstit dhe c) elementë në formën e kuadrateve.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Mbi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

Pavlina DOÇAJ – Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data:

Nr:

Ora:

VENDIM

MBI

**MIRATIMIN E DISA ELEMENTËVE PËRMBAJTËSORË TË FLETËS SË VOTIMIT,
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 97 pika 1 dhe nenit 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 6, datë 6.2.2025, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”, si dhe vendimit nr. 7, datë 14.2.2025 “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOS:

1. Miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data:

Nr:
Ora:



“Mbi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimi për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Lidhja 1

Disa elementë përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025

Elementë të përgjithshme:

Stema e Republikës,
Logo KZQV

Elementë në formën e tekstit:

Republika e Shqipërisë
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Fletë votimi:
Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 11 Maj 2025:
Qarku
QV nr.
Emri i subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion/ kandidat i propozuar nga zgjedhësi)
Emri i kryetarit të subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion)
Shkronjat nistore të subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion)
Numri rendor

Elementë në formën e kuadrateve :

Kuadrat (i bardhë) ku bëhet shënimi i votuesit
Kuadrat ku vendoset emri i subjektit zgjedhor
Kuadrat ku vendoset logo e subjektit zgjedhor
Kuadrat ku vendoset numri rendor

Data: Nr:
Ora:



“Mbi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimi për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”

